

# *Ndikimi i aftësive motorike në suksesin e futbollistëve në regjionin e Gjilanit të moshës*

*14-16 vjeçare*

*Blerim Sylejmani\**

*Arben Maliqi\*\**

*Gazmend Preniqi\*\*\**

*Florie Azizi – Maliqi\*\*\*\**

## **Abstrakt**

Hulumtimet mbi ndikimin dhe marrëdhëniet në mes të aftësive bazike - motorike dhe situacionale – motorike është një proces i vazhdueshëm që nxjerr në pah ndikimin e aftësive bazike – motorike në testet situacionale – motorike të futbollistëve të regjionit të Gjilanit, që janë pjesë përbërëse në elitën e futbollit kosovar. Qëllimi kryesor i këtij punimi është përcaktimi i ndikimit të performancës së aftësive motorike në analizën e dy testeve situacionale motorike të futbollistëve kadet. Në mostrën e të hulumtuarve janë përfshirë 98 futbollistë të regjionit të Gjilanit, të kategorisë së kadetëve, të cilët njëherit do të jenë përfaqësues të së ardhmës së futbollit kosovar e më gjerë. Në këtë punim janë hulumtuar ndikimi i disa dimensioneve në hapësirën motorike nga: (forca eksplozive, frekuenca e shpejtësisë së krahëve dhe këmbëve, koordinimit dhe fleksibilitetit) me gjithsej 12 variabla dhe dy testeve të motorikës situacionale (shpejtësia e udhëheqjes së topit në vijë të drejtë dhe goditjes së topit me kokë). Metoda e aplikuar në këtë punim është analiza regressive, e përpunuar përmes paketës SPSS statistics. Pas përpunimit të

---

\* Blerim Sylejmani, Kolegji AAB. Email: [blerim.sylejmani@aab-edu.net](mailto:blerim.sylejmani@aab-edu.net)

\*\* Arben.Maliqi, Kolegji AAB. Email: [arben.maliqi@aab-edu.net](mailto:arben.maliqi@aab-edu.net)

\*\*\* Gazmend Preniqi, Kolegji AAB. Email: [gazmend.preniqi@aab-edu.net](mailto:gazmend.preniqi@aab-edu.net)

\*\*\*\* Florie Azizi Maliqi SHME "Marin Barleti" Gjilan. Email: [florie.maliqi@gmail.com](mailto:florie.maliqi@gmail.com)

rezultateve vërejmë se në rezultatet e testeve situacionale të koordinimit , ndikim të rëndësishëm kanë treguar variablat, vrapim me hapa anash dhe sllallom si dhe në testin situacionalo - motorike (goditja e topit me kokë), ndikim të rëndësishëm kanë treguar variablat vrapim me hapa anash, vrapim në drejtkëndësh (testi zarf), kërcim nga vendi në gjatësi dhe kërcim (trehapësh).

**Fjalë kyç:** *Futbollistë, aftësi motorike, koordinim, goditje, regression.*

## *Hyrje*

Futbolli pa dyshim se është sporti më i dashur për fëmijë dhe të rritur, njëkohësisht sporti më i popullarizuar në planet. Atëherë mund të themi se është një lojë planetare, e cila luhet në gjashtë kontinente dhe shikohet nga mbi tre miliardë shikues dhe si i tillë zë vendin e parë në kuadër të lojrave sportive. Loja e futbollit gjithnjë është në rritje nga të gjitha dimensionet si nga kualiteti, atraktiviteti, financat dhe pjesëmarrja aktive e gjithanshme nga mbarë bota. Edhe Kosova u inkorporua në shtëpitë më të njohura botërore në UEFA dhe FIFA në vitin 2016, që tani edhe futbollistët tanë i kanë dyert e hapura për t'i treguar kualitetet e tyre krahas futbollistëve me nam. Me krenari kisha për t'i përmendur emrat si: Shaqiri, Xhaka, Xhemajli, Cana, Behrami, Rashica e shumë të tjerë, që sot janë faktorë motivimi për lojtarët e rinj, të cilët janë duke ushtruar dhe mund t'i ndjekin hapat e tyre.

Futbolli bashkëkohor kërkon nivel të lartë të përgatitjeve tekniko - taktike, e në veçanti aftësitë bazike - motorike siç janë : shpejtësia, forca eksplozive, fleksibiliteti, koordinimi, barazpesha dhe qëndrueshmëria janë indikator kryesor në realizimin e detyrave situacionale në lojën e futbollit. Përcaktimi i dimensioneve, të cilët definojnë lidhjen në mes variablave bazike - motorike dhe situacionale - motorike si dhe ndikimin

në suksesin e futbollistëve kadet është shumë kompleks dhe problem shumë dimensional. Rrjedhat e futbollit modern domosdoshmërisht kanë imponuar një qëndrim shkencor dhe qasje të re ndaj kësaj disipline sportive. Natyrisht raporti i tillë i bazuar në aspektin profesional, shkencor ndaj futbollit mundëson zhvillimin dhe përparimin e mëtejshëm dhe i kontribuon popullaritet të tij edhe më të madh në kuadër të sporteve në përgjithësi. Analiza serioze e rrjedhave të futbollit modern, e përshkruar me një referim prognoze dhe kuptimi hipotetik për zhvillimin e futbollit në të ardhmen, nënkupton analizën serioze të historisë së futbollit. Vetëm faktet historike të zhvillimit të futbollit mundësojnë që më mirë të shikohen rrjedhat e futbollit modern si dhe shikimin profesional të zhvillimit të futbollit në të ardhmen. Punime të ngjashme në lëmin e futbollit kanë bërë shumë autorë, ndër të cilët po i përmend (Gabrijelić 1982, 1983)<sup>1</sup>, ka hulumtuar relacionet e motorikës situacionale dhe vlerësimin e suksesit të futbollistëve, si dhe ka përdorur metodat për seleksionimin dhe orientimin e fëmijëve dhe të rinisë për shkolla sportive<sup>2</sup>. Mehmeti, me bashkëpunorë, (2010), në hulumtimin e tij prej 88 futbollistëve në Bundes ligën gjermane ka vërtetuar ndikimin e aftësive bazike motorike në udhëheqjen e topit dhe precizitetit<sup>3</sup>. Mekić Midhat (1985) Në studimin e tij ka hulumtuar karakteristikat morfologjike, konative dhe aftësitë bazike motorike në testet

---

<sup>1</sup> Milivoje Gabrijelić Jerković Stjepan, etj Aubreht, Relacije situaciono - motoričkih faktora i ocjena uspjeha nogometaša. *Kineziologija*. Zagreb: Vol. XV, Br. 2: 1983. (53-63).

<sup>2</sup> Milivoje Gabrijelić, Stjepan Jerković etj., Analiza pouzdanosti i valjanosti situacijsko-motoričkih testova u nogometu. *Kineziologija*, 14-15 Zagreb: 1982. (149- 161).

<sup>3</sup> Ejup Mehmeti, etj. Utjecaj bazično motoričkih sposobnosti na brzinu vođenje lopte i preciznosti u nogometnoj igri njemačkih nogometaša - kadeta uzrasta 12-14 godina. Časopis za sport, fizičko vaspitanje i zdravlje, *Sport Mont*, broj 21-22. /VII. Podgorica: 2010. (84-90).

situacionale motorike.<sup>4</sup> NËpërmjet këtij punimi do të mundohemi të vërtetojmë ndikimin e disa aftësive bazike motorike në anën prediktore dhe suksesin në realizimin e testeve situacionale - motorike në anën kriterike të futbollistëve të regjionit të Gjilanit, të cilët janë pjesë aktive e klubeve dhe garojnë në ligën regjionale të Gjilanit. Duke u nisur nga fakti se futbollit si sporti më i popullarizuar në botë, ka ngjallur kureshtjen dhe interesimin për t' u marrë me lojën e futbollit, si rrjedhojë e kësaj vërehet një trend i rritjes së shkollave të futbollit dhe inkorporimin e të rinjëve në shkollat përkatëse. Në regjionin e Gjilanit garojnë dhjetë shkolla të futbollit duke i përfshirë edhe klubet me kategoritë e reja. Hulumtime të tilla që kanë të bëjnë me performancën e lojtarëve të rinj janë të pakta, andaj jam munduar të jap një kontribut modest lidhur me problematikën e hulumtimit.

## *Metodologjia*

Në këtë hulumtim është marrë mostra prej 100 futbollistëve të moshës 14-16 vjeçarë nga regjioni i Gjilanit, KF. Gjilani, KF. Drita, KF. Shkëndija, KF. Gallaksia, KF. Vitia me nga 20 futbollistë. Gjatë matjeve bazike - motorike dy futbollistë kanë munguar për shkaqe shëndetësore 98 futbollistë u janë nënshtruar testimi në ora 10:00 në sallën e ed.fizike "Marin Barleti" në Gjilan, duke filluar prej 20 - 25 Prill 2015, për çdo ditë nga një ekip prej 20 futbollistësh kurse testet situacionale motorike në stadiumin e qytetit prej orës 13:00.

---

<sup>4</sup> Midhat Mekić, Kanonička relacija između morfoloških, motoričkih i konativnih karakteristika i rezultata situacijsko-motoričkim testovima u nogometu. Zbornik del, šesta letna škola" Kranska Gora".1985 (209 - 221).

## ***Mostra e variablave***

Në këtë punim janë trajtuar 12 variabla në hapësirën manifeste të motorikës bazike dhe dy variabla të motorikës situacionale, të cilat janë të marrë nga Kureliqi me bashkëpunorë (1975) sipas Sylejmanit (2014)<sup>5</sup>.

### ***Variablat e motorikës bazike***

Në hapësirën manifeste janë trajtuar me nga katër teste që i përkasin hapësirës së forcës eksplozive, strukturës së frekuencës së shpejtësisë dhe hapësirës së koordinimit:

#### ***Variablat për vlerësimin e forcës eksplozive***

1. MKVGJA - Kërcim së gjati nga vendi,
2. MKVLAR - Kërcim nga vendi në lartësi,
3. MKTREH - Kërcim trehapësh nga vendi,
4. MVR20M - Vrapim 20 metra nga starti lartë,

#### ***Variablat për vlerësimin e frekuencës së shpejtësisë***

1. MTAPKË - Taping me këmbë,
2. MTAPKM - Taping me këmbë në mur,
3. MRRRDO - Rrethrotullimi i dorës rreth tamburet, ,
4. MRRRKË - Rrethrotullimi i këmbës,

#### ***Variablat për vlerësimin e koordinimit dhe fleksibilitetit***

1. MUTSLL - Udhëheqja e topit sllallom,
2. MKHANS - Vrapim me hapa anash,
3. MKVZAR - Vrapim drejtëkëndësh (zarf) dhe
4. MFPTAV - Përkulje para në tavolinë

---

<sup>5</sup> Blerim Sylejmani, *Taksonomska analiza morfološkkih, bazično-motoričkih, konativnih i situaciono-motoričkih dimenzija i njihov utjecaj na uspješnost nogometaša kadeta*: Doktorska disertacija, Fakultet Sporta i Tjelesnog Odgoja, Sarajevo: 2014 f. (113 - 134)

### ***Variablat situacionale - motorike***

1. MSSHUNK – Shpejtësia e udhëheqjes së topit në vijë të drejtë me ndërrimin e kahjes
2. MSGTKO – Goditja e topit me kokë.

### ***Diskutimi i rezultateve***

Rezultatet janë përpunuar përmes paketes statistikore SPSS version 19 duke analizuar metodën regressive, tek të dy testet e motorikës situacionale si variabla kriterike dhe variablave të aftësive bazike – motorike në sistemin prediktor në hapësirën manifeste motorike.

Duke u bazuar në qëllimin e këtij punimi analiza regressive është aplikuar për të treguar se çfarë ndikimi kanë variablat kriterike tek futbollistët e regjionit të Gjilanit, gjithashtu mund të parashikojmë efikasitetin se në çfarë mase mund të ndikojnë ndryshoret kriterike të dimensioneve situacionale – motorike në raport me aftësitë bazike - motorike. Korelacioni i shumfishtë (multipël), (R), i cili tregon vlerën e korelacionit ndërmjet të gjitha ndryshoreve prediktore dhe asaj kriterike. Koeficienti i determinacionit (Adjusted R Square), i cili tregon përqindjen e variancës së përbashkët në mes të ndryshoreve prediktore dhe asaj kriterike, (df1 dhe df2) që shpjegojnë shkallët e lirisë. Vlefshmëria (Sig F change), e cila tregon vlefshmërinë statistikore në nivelin e besueshmërisë .01. po ashtu për plotësimin dhe kuptimin me detaje të relacioneve si dhe përcaktimin e ndikimit parcial të ndryshoreve prediktore në kriter, janë paraqitur edhe vlerat e koeficientit parcial (Beta) dhe korelacionit parcial (Part), i cili paraqet korelacionin parcial në mes variables prediktore dhe variables kriterike, pasi të jenë të eliminuara ndikimi i të gjitha ndryshoreve të tjera.

**Tabela 1. Analiza regressive e shpejtësisë së udhëheqjes së topit me ndërrimin e kahjes në kënd të drejtë**

Model	R. korelacioni i shumëfishtë	R Përqindja	Përqindja e variacionit të përbashkët	Gabimi standard i vlerësimit	Ndryshimet statistikore					
					R Ndryshimi në katror	F	df 1	df 2	Vlefshmëria	
1	.635 <sup>a</sup>	.404	.319	.51471	.404	4.794	4	12	85	.000

a. Prediktorët: (konstant), MFPTAV, MVR20, MKHANS, MRRRDO, MKVZAR, MTAPKM, MKTREH, MTAPKË, MUTSL, MRRRË, MKVGJA, MKVLAR

**ANOVA<sup>a</sup>**

Model		Shuma në katror	Df (shkallët e lirisë)	Mesi aritmetik në katror	F	vlera.
1	Regresioni	15.242	12	1.270	4.794	.000 <sup>b</sup>
	Mbetja	22.518	85	.265		
	Gjithsej	37.760	97			

a. Variabla Kritererike: MSSHUNK

**Koeficienti<sup>a</sup>**

Model		Koeficientët e parabartë		Koeficienti i standardizuar	T	Vlera.
		B	Gabimet gjatë matjes	Beta		
1	(Constant)	1.140	3.385		.337	.737
	MKVGJA	.001	.005	.014	.127	.900
	MKVLAR	.028	.017	.206	1.603	.113
	MKTREH	-.002	.002	-.128	-.993	.323
	MVR20M	-.440	.326	-.131	1.349	.181
	MTAPKË	-.067	.032	-.206	2.079	<b>.041</b>
	MTAPKM	.038	.021	.194	1.820	<b>.072</b>
	MRrDO	.007	.016	.040	.411	.682
	MRrKË	.002	.027	.008	.073	.942
	MUTSLL	.147	.053	.285	2.779	<b>.007</b>
	MKHANS	.604	.142	.440	4.249	<b>.000</b>
	MKVZAR	.104	.070	.142	1.484	.141
	MFPTAV	.005	.014	.038	.374	.710

a. Variabla Kritetrike: MSSHUNK

**Tabela 1.** Analiza regressive e shpejtësisë së udhëheqjes së topit me ndrimin e kahjes në kënd të drejtë

Model	R korelacioni i shumëfishtë	R Përqindja	Përqindja e variancës së përbashkët	Gabimi standard i vlerësimit	Ndryshimet statistikore				
					Përqindja e variancës	F Ndryshimi	df1	df2	Vlefshmëria
1	.635 <sup>a</sup>	.404	.319	.51471	.404	4.794	12	85	.000

a. Prediktorët: (konstant), MFPTAV, MVR20M, MKHANS, MRRRDO, MKVZAR, MTAPKM, MKTREH, MTAPKË, MUTSLL, MRRRË, MKVGJA, MKVLAR



**ANOVA<sup>a</sup>**

Model	Shuma në katror	Df	Mesi aritmetik. katror	F	Sig.
1 Regresioni	15.242	12	1.270	4.794	.000 <sup>a</sup>
Mbetja	22.518	85	.265		
Gjithsej	37.760	97			

a. Variabla kriterike: MSSHUNK

**Coefficients<sup>a</sup>**

Model	Koeficientët e pa standardizuar		Koeficienti i standardizuar	T	Vlera.
	B	Gabimi standard	Beta		
1 (Constant)	1.140	3.385		.337	.737
MKVGJA	.001	.005	.014	.127	.900
MKVLAR	.028	.017	.206	1.603	.113
MKTREH	-.002	.002	-.128	-.993	.323
MVR20M	-.440	.326	-.131	-1.349	.181
MTAPKË	-.067	.032	-.206	-2.079	<b>.041</b>
MTAPKM	.038	.021	.194	1.820	<b>.072</b>
MRrRDO	.007	.016	.040	.411	.682
MRrRKË	.002	.027	.008	.073	.942
MUTSLL	.147	.053	.285	2.779	<b>.007</b>
MKHANS	.604	.142	.440	4.249	<b>.000</b>
MKVZAR	.104	.070	.142	1.484	.141
MFPTAV	.005	.014	.038	.374	.710

a. Variabla kriterike: MSSHUNK

Në tabelën 1, janë paraqitur vlerat e testeve bazike - motorike të futbollistëve në sistemin prediktor dhe nëpërmjet analizës regresive në relacionet e ndryshores kriterike MSSHUNK - Shpejtësia e udhëheqjes së topit me ndërrimin e kahjes në vijë të drejtë, nga pozicioni i lartë, na jep rezultate të vlefshme signifikante .01, në bazë të koeficientit të korelacionit të shumëfishtë ( $R_o = 635$ ) mund të shpjegohet 40.4% e variabilitetit të përbashkët të sistemit prediktor dhe ndryshores kriterike,

pjesa tjetër prej 59.6 % është nën ndikimin e faktorëve të panjohur dhe të pa përfshira në këtë punim. Në bazë të vlerave të fituara nga dymbëdhjetë (12) variabla të aftësive bazike – motorike, prej të cilave rezultate më të mira kanë treguar testet nga sistemi i testeve të koordinimit siç janë: MKHANS – vrapim me hapa anash me sig .000, pastaj testi MUTSLL - Udhëheqja e topit në sllallom në nivel .007, Si dhe testet me ndikim parcial e që i përkasin sistemit të ndryshoreve të frekuencës së shpejtësisë si MTAPKË - taping me këmbë ulur në vlerë (.041) dhe ndryshorja MTAPKM - taping me këmbë në mur në vlerë (.072) , nga kjo mund të konkludojmë se loja e futbollit është komplekse e përcjellur me aksione të papritura gjatë lojës në hapësirë dhe kohë, e që manifestohen në lojë me driblim, mashtrim apo goditje, për të arritur drejt cakut kryesor, portës (shënimit të golit). Kështu për shembull përgatitja teknike e futbollistëve në masë të madhe varet nga shkalla e aftësive motorike dhe funksionale.

**Tabela 2.** Analiza regressive e goditjes së topit me kokë

Model	R korelacioni i shumëfishtë	R Përqindja	Përqindja e variancës së përbashkët	Gabimi standard i vlerësimit	Change Statistics				
					Përqindja e variancës	F Ndryshimi	df1	df2	Sig. F Vlera
1	.606 <sup>a</sup>	.368	.278	1.04726	.368	4.116	12	85	.000

a. Prediktorët: (Constant), MFPTAV, MVR20M, MKHANS, MRrRDO, MKVZAR, MTAPKM, MKTREH, MTAPKË, MKSLLA, MRrRKË, MKVGJA, MKVLAR.

ANOVA <sup>a</sup>						
Model		Shuma në katror	df	Shuma në katror	F	Vlera.
1	Regresioni	54.175	12	4.515	4.116	<b>.000<sup>b</sup></b>
	Mbetja	93.225	85	1.097		
	Gjithsej	147.400	97			

a. Variabla kriterike: MSGTKO

b. Predictors: (Constant), MFPTAV, MVR20M, MKHANS, MRrRDO, MKVZAR, MTAPKM, MKTREH, MTAPKM, MUTSLL, MRrRKË, MKVGJA, MKVLAR

Coefficients <sup>a</sup>						
Model		Koeficientët e pa standardizuar		Koeficienti i standardizuar	t	Vlera.
		B	Gabimi standard	Beta		
1	(Constant)	26.367	6.888		3.828	.000
	MKVGJA	.008	.011	.084	.720	.474
	MKVLAR	-.073	.035	-.272	-2.060	<b>.042</b>
	MKTREH	.009	.005	.253	1.902	<b>.061</b>
	MVR20M	.295	.664	.044	.444	.658
	MTAPKË	-.018	.066	-.029	-.281	.780
	MTAPKM	-.001	.042	-.003	-.027	.978
	MRrRDO	.043	.033	.130	1.295	.199
	MRrRKË	.006	.055	.011	.103	.918
	MUTSLL	-.061	.108	-.060	-.566	.573
	MKHANS	-1.099	.289	-.405	-3.798	<b>.000</b>
	MKVZAR	-.359	.143	-.247	-2.513	<b>.014</b>
	MFPTAV	.017	.029	.060	.582	.562

Në tabelën 2, janë paraqitur vlerat bazike - motorike të futbollistëve në sistemin prediktor dhe nëpërmjet analizës regresive në relacionet e testeve kriterike MSGTKO - Goditja e

topit me kokë, nga pozicioni i lartë, na jep rezultate të vlefshme signifikante .000, në bazë të koeficientit të korelacionit të shumëfishtë ( $R_o = 606$ ) mund të shpjegohet 36.8% e variabilitetit të përbashkët të sistemit prediktor dhe variablës kriterike. Pjesa tjetër prej 63.2% është nën ndikimin e faktorëve të panjohur dhe të pa përfshira në këtë punim. Në bazë të vlerave të fituara është vërtetuar se ndryshorja MKHANS - vrapim me hapa anash, e sistemit prediktor ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në variablën kriterike MSGTKO me vlerë (sig. 000), si dhe ndryshorja MKVZAR - vrapim drejtëkëndësh (zarf), ka ndikim statistikisht të rëndësishëm në variablën kriterike me vlerë (sig. 014), gjithashtu ndikim parcial kanë ndryshoret nga sistemi i testeve të forcës eksplozive MKVLAR - me vlerë ( sig.0.42) dhe ndryshorja MKTREH - kërcim trehapësh nga vendi, me vlerë (sig. 0.61) që jep të kuptosh se forca eksplozive dhe koordinimi, është bazë për realizimin e detyrave situacionale motorike. Me inspektimin e rezultateve vërehet se në realizimin e detyrës motorike situacionale ndikim kanë testet që i përkasin hapësirës hipotetike motorike: koordinimit, forcës eksplozive e që kanë të bëjnë me përceptimin e hapësirës, kohës dhe momentit të goditjes më të suksesshme.

### *Përfundimi*

Duke u bazuar në synimet dhe rëndësinë e këtij punimi ka qenë njohja dhe ndikimi i aftësive bazike - motorike në realizimin e testeve situacionale motorike, pas përpunimit, interpretimit dhe analizës së rezultateve, ne mund të konstatojmë se në mënyrë të plotë është realizuar qëllimi i parashtruar në fillim të punimit që tregojnë se rezultatet e futbollistëve të moshës 14-16 vjeç, kanë treguar rezultate të vlefshme statistikore dhe mund të konkludojmë se është arritur një konkludim statistikisht i vlefshëm.

Mostra e përfshirë në këtë punim prej 98 futbollistëve nga pesë klube në regjionin e Gjilanit, të cilët u janë nënshtruar dymbëdhjetë (12) testeve të aftësive bazike - motorike në sistemin prediktor në hapësirën manifeste dhe dy testeve të motorikës situacionale në sistemin kriterik e që janë kryer gjithsej 1372 matje, prej të cilave testet e forcës eksplozive, frekuenca e shpejtësisë dhe koordinimit kanë rezultuar me signifikant. (.000 ) të bazuara në dy testet e motorikës situacionale, na japin një pasqyrë reale të aftësive nga aftësitë bazike - motorike të futbollistëve të regjionit të Gjilanit për realizimin e detyrave motorike në lojën e futbollit. Lirisht mund të themi se treguesit e rezultateve të arrituara në testet e motorikës situacionale nxjerr në pah dy konkluzione kryesore:

Rezultatet në testet e motorikës bazike kanë ndikim në vlerë ( $p=.01$ ) në nivel të arritjes së rezultateve në testet e motorikës situacionale si dhe në arritjen e rezultateve të motorikës situacionale, shumë më tepër ndikojnë indikatorët e motorikës bazike, të cilët janë nën ndikimin e sistemit për rregullimin e energjisë se sa aftësitë fizike, të cilat janë nën ndikimin e sistemit për rregullimin e lëvizjes.

Ky punim është një udhërefyese për trajnerët, pedagogët e kulturës fizike, të cilët janë drejtpërdrejt të lidhur me gjenerata të reja dhe janë pjesë përbërse e procesit stërvitor me qëllim të ngritjes profesionale në lojën e futbollit.

## **Bibliografija**

Gabrijelić, Milivoje. Jerković, Stjepan. Aubreht, Vladimir. Elsner Branko. "Analiza pouzdanosti i valjanosti situacijsko-motoričkih testova u nogometu". *Kineziologija*. 14-15. Zagreb: (149- 161). 1982.

Gabrijelić, Milivoje. Jerković, Stjepan. Aubreht, Vladimir. Elsner Branko. "Relacije situaciono – motoričkih faktora i ocjena uspjeha nogometaša". Zagreb: *Kineziologija* Vol. XV, Br. 2, str.53-63. 1983

Selimović Ismail. Mehmeti Ejup. „Utjecaj Bazičnih motoričkih sposobnosti na brzinu vođenja lopte i preciznost u nogometnoj igri“. Podgorica: Časopis za sport, fizičko vaspitanje i zdravlje, *Sport Mont*, broj 25-27. VII. (166-178). 2011.

Jerković, Stjepan. Relacije između situacijsko - motoričkih i elemenata tehnike u nogometu. Zagreb: *Kineziologija*. (23) 1-2: 33-40, 1991

Maliqi, Arben. „Efekti situacionog metoda rada na poboljšanje morfoloških odlika, bazično – motoričkih i situaciono – motoričkih sposobnosti i uspjehnosti u nogometnoj igri: Doktorska disertacija“. Fakultet Sporta i Tjelesnog Odgoja Sarajevo. 2014

Mehmeti, Ejup. Hodžić, Muhedin. Hadžiahmetović, Amela. i Ferić, Aldin. „Utjecaj bazično motoričkih sposobnosti na brzinu vođenje lopte i preciznosti u nogometnoj igri njemačkih nogometaša - kadeta uzrasta 12-14 godina“. Časopis za sport, fizičko vaspitanje i zdravlje, *Sport Mont*, Podgorica: broj 21-22/VII, f. 84-90. 2010.

Mekić Midhat. „Kanonička relacija između morfoloških, motoričkih i konativnih karakteristika i rezultata situacijsko – motoričkim testovima u nogometu“. *Zbornik del, šesta letna škola Kranska Gora*. f. 209 – 221, 1985.

Sylejmani Blerim, Maliqi Arben. „Structure of morphologic characteristics among football players – (age 14-16 years old)“.

*Ndikimi i aftësive motorike në suksesin e futbollistëve në regionin e Gjilanit të moshës 14-16 vjeçare*

Podgorica: *Sport Mont*, Časopis za sport i zdravlje Crnogorska sportska akademija. br. 34-36 / X, f.546-550. 2012

Sylejmani, Blerim. „*Taksonomska analiza morfoloških, bazično-motoričkih, konativnih i situaciono-motoričkih dimenzija i njihov utjecaj na uspješnost nogometaša kadeta*“. Doktorska disertacija. Fakultet Sporta i Tjelesnog Odgoja Sarajevo. 2014

